



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 0976 Prot

Tiranë, më 21.11. 2023

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi të brendshëm (me procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë brenda sistemit doganor)

Drejtuar: DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE  
DREJTORIVE NË D.P.DOGANAVE  
DEGËVE DOGANORE

Për publikim: DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE  
DREJTORISË SË KOORDINIMIT DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të pikave 5 dhe 6 të nenit 15 të ligjit nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, të Kreut II dhe III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 921 datë 29.12.2014 "Për Personelin e Administratës Doganore", i ndryshuar, shpall konkurimin e brendshëm për pozicionin

**Specialist Analiz Risku /Aposterior/Jurist/Borxhi, Aeroporti i Kuksit.**  
Kategoria C1, Kategoria e pagës III- b (një vendë)

#### Përshkrim përgjithësues për pozicionin:

- a) Monitorimi ne mënyre te vazhdueshme i sistemit elektronik te përpunimit te deklaratave doganore, me qellim përcaktimin e rasteve me risk dhe dukurive te tjera qe pengojne Degën e Doganës në arrijen e objektivave të saj;
  - b) Grumbullon dhe përpunon informacionin për lëvizjen dhe gjendjen e mjeteve që janë nën mbikqyrje doganore ose priten të mbërrijnë në territorin doganor referuar indikatorëve të riskut.
  - c) Shqyrton të dhënat në dispozicion mbi mjetet, mallrat dhe subjektet që kryejnë procedura doganore në degen doganore perkatese, në kohë reale;
  - ç) Kërkon nga strukturat doganore informacion shtesë mbi mjetet e transportit, mallrat apo subjektet e dyshuara;
  - d) Bën klasifikimin e riskut lokal bazuar në indikatorët përkatës dhe përcakton nivelin e kontrollit duke u mbështetur në udhëzimet përkatëse dhe të dhënat në dispozicion;
- dh) Përcaktimi i një niveli me te larte kontrolli nga ai i përcaktuar automatikisht nga sistemi nepermjet rikanalizimit të deklaratës doganore në sistem per rastet e vlerësuara me risk gjate monitorimit;

- e) Vlerëson, analizon informacionet e mbledhura ne bashkëpunim me sektorët e tjerë te degës doganore, dhe propozon ndërtimin e profileve të reja të riskut apo rishikimin e profileve ekzistuese qe veprojne ne doganën përkatëse në përputhje me procedurat e parashikuara për këtë qëllim;
- ë) Propozimi i masave te ndryshme qe duhen ndërmarrre per shmangien e dukurive qe pengojnë Degën e Doganës në arritjen e objektivave te saj, te konstatuara gjate monitorimit/analizimit;
- f) Kryen here pas here mbikqyrje nese kontrollet kryhen konform mesazheve perkatese te profileve te riskut dhe nese rezultatet e kontrollit pasqyrohen ne aktin e kontrollit;
- g) Raporton pranë Drejtorisë së Informacionit, Analizes se Riskut dhe Monitorimit në DPD per situaten ne doganen ku punon;
- gi) Mbeshtetur ne udhezimet përkatëse, ndjek, zbaton dhe informon Kryetarin e Doganes per cdo produkt te nxjerre apo te parashikuar ne nivel strategjik, taktik dhe operacional;
- h) Pasurimi i bazave te te dhënavë qe i sherbejne Drejtorisë së Analizës së Riskut dhe Monitorimit në D.P.D si burime informacioni per menaxhimin e riskut kombetar;
- i) Përgatit raporte, analiza rishku, statistika per shkeljet dhe treguesit qe ulin te ardhurat doganore, duke bashkëpunuar me Drejtoren e Informacionit, Analizes se Riskut dhe Monitorimit në DPD.
- j) Merr pjesë në komisionet, grupet e punës, task-force, të ngritura për çështje të ndryshme.
- k) Përgatit ne funksion te Degës Doganore plane pune, plane operacionale te ndryshme, analiza pune si dhe cdo material tjetër te kërkuar nga Kryetari i Degës së Doganore, në përputhje me ligjin;
- l) Bashkëpunon me strukturat e tjera të Administratës Doganore gjatë ushtrimit të kontrolleve dhe informohet për ndryshimet dhe vendimet më të fundit ligjore që ndikojnë në punën e tij duke informuar përkatësisht eprorin e drejtpërdrejtë;
- ll) Ruan konfidencialitetin për punën e bërë nga sektori, ndalohet të bëjë publike informacione apo çështje në proces që mund të vënë në rrezik objektivat e Deges Doganore;
- m) Përbush cdo detyrë të përcaktuar në akte ligjore, nënligjore, akte të DPD, që i ngarkohen këtij pozicioni pune si dhe përbush detyrat që i ngarkohen nga struktura eprore në përputhje me ligjin.

**Jurist/Specialist Borxhi, janë:**

- a) Administron dhe ndjek proceset gjyqësore ne te gjitha shkallet e gjykimit bazuar në legjislacionin Doganor dhe legjislacionin shqiptar në përgjithësi;
- b) Ushtron për cdo rast vendimi ne disfavor të administratës doganore ankimin apo rekursin ne gjykaten e Apelit apo Gjykaten e Larte;
- c) Ndjek praktikat përbirimore administrative dhe gjyqësore për vendimet gjyqësore të formës së prerë duke koordinuar veprimtarinë me Financën dhe D;P;D;
- d) Ndjek praktikat qe lidhen me nxjerjen e urdherave ekzekutive per titujt ekzekutive me qellim rikuperimin e borxhit doganor duke koordinuar veprimtarinë me Financën dhe D.P.D.;
- e) Kryen konfirmimet e nevojshme sipas akteve në fuqi për elementë të caktuar të aktivitetit të tij;
- f) Bashkëpunon me D.P.D dhe Avokaturën e Shtetit për proceset gjyquesore të rëndësishme ku Dega e Doganës është palë;
- g) Raporton në mënyrë periodike dhe zbaton detyrat e ngarkuara nga Drejtoria Juridike në DPD si strukturë nga e cila varen teknikisht;
- h) Raporton apo konfirmon kur dicka e tille kërkohet sipas ligjit prane drejtorive kompetente ne D.P.D mbi ecurine e proceseve gjyqësore si dhe kërkon prova shkresore si dhe dokumentacion informues me qellim vazhdimin e metejshem te procedurave ligjore;
- i) Zbaton me korrektesë të gjitha delegimet për administrim të proceseve gjyqësore si dhe urdhëresat mbi administrimin korrekt të ceshtjeve gjyqësore;

- j) Përgatit vendime, urdhra te brendshem, kontrata etj., dhe raporte në vijimesi për Kryetarin e Doganës si dhe analizat e punës në periodicitet për periudhat e këruara.
- k) Mbeshtet sektoret e tjere me ndihme dhe keshilla juridike;
- l) Evidenton dhe perpunon informacionin që kanë lidhje me shkeljet doganore te konstatuara dhe vendimet e marra për to;
- m) Evidenton borxhin doganor per periudhat mujore progresive;
- n) Bashkepunon me agjensi të tjera si Tatimet, Pushtetin Lokal, Policinë, Transportin Rrugor, Bankat,
- o) Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme etj. per rikuperimin e borxhit te mbeshtetur me Urdher Ekzekutimi;
- p) Pergatit njoftimet, urdherat, kërkesat etj, të lidhura me borxhin doganor sipas afateve dhe procedurave ligjore ne fuqi;
- q) Pergatit evidencen mujore dhe progresive te borxhit doganor të Degës Doganore dhe dergimin e saj në D.P.D;
- r) Garanton zbatimin me perpikmeri te Urdherave dhe Udhezimeve te Kryetarit të Degës Doganore për borxhin doganor;
- s) Ndjek dhe zbaton me korrektesi te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga Akt – Marreveshjet e bashkepunimit te lidhura me Instucionet/Agjensitë e tjera;
- t) Përgatit plane pune sipas porosisë së Kryetarit të Doganës dhe mbështet sektorët e tjerë me ndihmë dhe keshilla juridike;
- u) Ndjek dhe përgatit në kohë dhe me korrektesi të gjitha shkresat që i adresohen;
- v) Merr pjesë në komisionet, grupet e punës, task-force, të ngritura për çështje të ndryshme;
- w) Përbush çdo detyre tjetër të përcaktuar në akte ligjore, nënligjore, akte të DPD, që i ngarkohen këtij pozicioni pune si dhe përbush detyrat që i ngarkohen nga Kryetari i Doganës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave brenda fushës së detyrave funksionale, në përputhje me ligjin

Kandidatët që konkurojnë për këtë vend pune duhet të plotësojnë këto kriterë:

#### **Kriteret minimale:**

- Të ketë një vlerësim pozitiv apo një certifikatë/vërtetim për një kualifikim të posaçëm profesional, që i përshtatet vendit të ri të punës
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi
- Të përbushë kriteret e veçanta në shpalljen për konkurim
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar

#### **Kriteret e veçanta:**

- Të zotërojnë diplomë të nivelit të parë dhe “Master Profesional” ose diploma të barazvlefshme me të sipas legjisacionit të arsimit të lartë në shkencat Ekonomike, Juridike, Natyrore.
- Të ketë mbi 1 vitë eksperiencë pune në Administratën Doganore.

Për të qenë pjesëmarrës në konkurrim, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm brenda datës 01.12.2023 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

#### **1. Kërkesë përmarrje pjesë në testim**

2. Curriculum Vitae
3. Rekomandim nga eprori direkt.

**Fusha e Njohurive:**

- 1.Ligji nr102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar:
- 2.Ligji nr. 61/2012 datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar:
3. Urdhëri nr. 123, datë 09.11.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhërin nr. 90, datë 18.11.2014 “Për miratimin e Kodit të Etikës në Shërbimin Doganor Shqiptar.
4. Ligji nr.9947 datë 07.07.2008 “Për Pronesine Industriale”, i ndryshuar.
5. Ligji nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar.
6. Ligji nr. 8874, datë 29.03.2002 “Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndeve narkotike dhe psikotrope”.
7. Ligji nr. 9367, datë 07.07.2015 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar
8. Urdhëri nr. 146, datë 07.05.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për miratimin e Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e Degëve Doganore:
9. Ligji nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar,  
Procedura e përzgjedhjes do të bëhet në mbështetje të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë ekzekutive*”, vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, “*Për personelin e administratës doganore*”, i ndryshuar.

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike [“www.dap.gov.al”](http://www.dap.gov.al).

